



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE



VLERËSIM I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR 2025

22 maj 2025

Ora 10:00

Lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë, Dituri natyre

Udhëzime për nxënësin:

Testi ka në total **60 pikë**.

- 27 pikë për gjuhën shqipe
- 21 pikë për matematikën
- 12 pikë për diturinë e natyrës

Në pyetjet me zgjedhje qarkoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **1 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Pikë											
Pyetja	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22
Pikë											
Pyetja	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33
Pikë											
Pyetja	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44
Pikë											
Pyetja	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	
Pikë											

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1 Anëtar

2 Anëtar

Gjuhë shqipe

Pjesa I

Në mbrojtje të natyrës

Në parkun pranë shtëpisë së Kokosë, Estes dhe Ales kishin vendosur lodra të reja. Me të mbaruar mësimet, fëmijët nxituan për te parku, ku i priste Drini, shoku i ngushtë i Estes. Pas i ndiqte Magi, qenushi i vogël bukurosh.

Fëmijët nisën lojërat duke vrapuar pas Magit e duke u kënaqur shumë. Por, ndërsa vraponin, Magi lëshoi një angullimë dhe ndaloi në vend. Kokoja u ul menjëherë pranë tij. Kur ç'të shihte, një copë xhami i ishte ngulur në putrën e pasme të djathtë. Fëmijëve iu mbushën sytë me lot. U mërztën kaq shumë, sa u iku dëshira për të vazhduar lojën.

- Mos u mërztisni, se do t'ia heq unë, - tha Drini dhe si një doktor i vogël ia hoqi xhamin Magit.

- Kur kisha dalë me gjyshin te sheshi në qendër të qytetit, u afrova te pëllumbat që rrinë aty, - vazhdoi Drini. - Njëri prej tyre nuk po e hapte dot sqepin. Sa keq më erdhi! Një copë çamçakëz i ishte ngjitur te sqepi. Gjyshi e mori pëllumbin në duar dhe ia hoqi me shumë kujdes.

- Disa njerëz nuk mendojnë fare për kafshët. I hedhin mbeturinat sa andej - këndeje, - tha Este shumë e mërztur.

- Edhe mua më ka treguar babi për peshqit që ngordhin në det prej naftës së anijeve, - tha Ale i vogël.

- A mund të bëjmë ne diçka për këtë gjë? - pyeti Kokoja.

- Të krijojmë fletëpalosje në mbrojtje të natyrës dhe kafshëve e t'i shpërndajmë në shkollat e qytetit, - tha Drini.

- Oh, sa bukur! - i shndritën sytë Estes. - Pastaj, fletëpalosjet, t'i firmosin kafshët.

- Po si t'i firmosin kafshët? - pyeti e çuditur Kokoja.

- Po ja, Koko, ngjyemë me bojë putrën e maçokut tënd, të Magit dhe të lepurushit tënd, Drin, - tha Este.

- Uaaa, sa mirë të shkoi në mendje! - folën me një zë fëmijët.

Pa e zgjatur, ata u kthyen në shtëpinë e Estes. Ajo mori në dorë penelin, e ngjeu në bojën e kuqe dhe shkroi me shkrimin e saj të bukur si ruazë:

"Natyra është e bukur, mos e shkatërmoni atë!"

Kafshët janë pjesë e natyrës. Ato meritojnë dashuri dhe kujdes."

Kokoja e zbukuroi përreth me disa flutura krahëshkruara. Magi, maçoku Riki dhe lepurushi i Drinit vunë mbi fletëpalosjet putrën e tyre të ngjyer me bojë të gjelbër. Në këtë çast, Este thirri babin:

- Babi, babi, a mund t'i shumëfishosh fletëpalosjet që krijuam ne?

- Po, patjetër, do t'jua shumëfishoj, - tha babi i mrekulluar kur pa fletëpalosjet me idetë e bukura të fëmijëve.

Të nesërmen, fëmijët së bashku me shokët, mësuesit dhe disa nga prindërit i shpërndanë ato në të gjitha shkollat e qytetit.

1. Este dhe Drini janë:

1 pikë

A) kushërinj.

B) shokë klase.

C) motër e vëlla.

D) shokë të ngushtë.

2. Ku shkuan fëmijët pasi mbaruan mësimet?

1 pikë

A) Në shtëpinë e Drinit.

B) Në parkun pranë shtëpisë.

C) Në parkun pranë shkollës.

D) Në sheshin e lodrave të reja.

3. Fëmijëve u iku dëshira për të vazhduar lojën sepse:

1 pikë

A) Magi u largua.

B) lodrat në park ishin prishur.

C) nuk i lejuan të luanin me Magin.

D) Magi u lëndua nga një copë xhami në putër.

4. Te sheshi në qendër të qytetit Drini kishte parë:

1 pikë

A) një pëllumb që nuk e hapte dot sqepin.

B) disa lepuj që hanin karota.

C) disa zogj që cicëronin.

D) një qen të madh.

5. Babai i kishte treguar Ales: A) për shumëllojshmërinë e peshqve që jetojnë në dete. B) për dëmin që u shkakton peshqve nafta e anijeve. C) për vlerat ushqimore të peshqve. D) për shumimin e peshqve.	1 pikë
6. Drini propozoi: A) të organizojnë një festë për kafshët. B) të protestojnë në mbrojtje të kafshëve. C) të bëjnë një album me foto të kafshëve. D) të krijojnë fletëpalosje në mbrojtje të natyrës dhe kafshëve.	1 pikë
7. Cili është pohimi i saktë? A) Ale shkroi me të kuqe dhe kafshët firmosën me blu. B) Este shkroi me të kuqe dhe kafshët firmosën me blu. C) Drini shkroi me të kuqe dhe kafshët firmosën me të gjelbër. D) Este shkroi me të kuqe dhe kafshët firmosën me të gjelbër.	1 pikë
8. Cili është mesazhi që shprehin fëmijët? A) Të vaksinojmë kafshët. B) Kafshët duhet të qëndrojnë të lira. C) Njerëzit të qëndrojnë larg kafshëve. D) Të mbrojmë natyrën dhe kafshët si pjesë e saj.	1 pikë
9. Pse u mrekullua babai? A) Sepse i pëlqyen fotot e Estes. B) Nga idetë e bukura të Kokosë. C) Nga idetë e bukura të fëmijëve. D) Sepse i pëlqeu albumi i fëmijëve.	1 pikë
10. Shkruani një këshillë për të mbrojtur natyrën, drejtuar të gjithë njerëzve.	1 pikë
11. Si është marrëdhënia e personazheve me kafshët në këtë pjesë?	1 pikë
12. Pse kafshët meritojnë dashuri dhe kujdes?	1 pikë
13. Gjeni një titull tjetër për pjesën.	1 pikë

Pjesa II

Pema e ullirit

Pema e ullirit është një nga bimët më të lashta në Shqipëri dhe në Mesdhe. Ulliri është bimë jetëgjatë e me gjelbërim të përhershëm. Ka rezistencë ndaj thatësisë, prandaj kërkon një klimë të ngrohtë e të thatë.

Trungu i ullirit ka dru të fortë e të rëndë. Ai ka formë jo të rregullt, me gunga e degëzime. Gjethet e ullirit janë me bisht të shkurtër, në formë ovale me ngjyrë të gjelbër të errët në anën e sipërme dhe të bardhë në të argjendtë në anën e poshtme. Lulet i ka të vogla e të bardha, në tufa. Fryti ka formë vezake, ngjyrë jeshile të errët deri në të zezë. Ai është i ndërtuar nga një tul i butë i cili përmban vaj, si dhe nga një bërthamë.

Ulliri është nga produktet më të vlefshme ushqimore për shëndetin e njeriut. E përdorim për prodhimin e vajit të ullirit i cili ka edhe veti shëruese. Prandaj, rekomandohet të përdoret edhe në mjekësi. Po ashtu e përdorim drejtpërdrejt në ushqim, për prodhimin e sapunit, shampove dhe kremrave.

Ekzistojnë shumë varietete të ullirit. Shqipëria është një nga vendet më të njohura për prodhimin e vajit të ullirit me cilësi të lartë dhe shije natyrore. Ai rritet i shëndetshëm në zonat kodrinore të vendit tonë.

14. Autori e shkroi këtë pjesë kryesisht:

1 pikë

- A) për të bindur lexuesin që të mbjellë ullin.
- B) për të na treguar si prodhohet vaji i ullirit.
- C) për të na udhëzuar si të rrisim bimën e ullirit.
- D) për të dhënë informacion për ullirin dhe pemën e ullirit.

15. Në fjalinë: “Gjethet e ullirit janë me bisht të shkurtër”, emri i nënvizuar është në rasën:

1 pikë

- A) gjinore.
- B) dhanore.
- C) kallëzore.
- D) emërore.

16. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “Ai rritet i shëndetshëm në zonat kodrinore të vendit tonë,” është:

1 pikë

- A) mbiemër.
- B) përemër vetor.
- C) përemër pronor.
- D) përemër pyetës.

17. Fjala *jetëgjatë* është:

1 pikë

- A) e parme.
- B) e përbërë.
- C) e përngjitur.
- D) e prejardhur.

18. Gjeni kryefjalën e fjalisë: “Trungu i ullirit ka dru të fortë e të rëndë.”

1 pikë

Kryefjala: _____

19. Rishkruani fjalinë e mësipërme duke e zëvendësuar kryefjalën me një përemër vetor.

1 pikë

Fjala: _____

20. Shkruani sinonimin e fjalës së nënvizuar në fjalinë: “Ulliri është një nga bimët më të lashta”.

1 pikë

21. Krijoni një fjali me foljen **kërkoj** duke e vendosur atë në kohën e kryer të thjeshtë, veta e tretë, numri njëjës.

1 pikë

22. Gjeni mbiemrin në fjalinë: “Vaji i ullirit ka edhe veti shëruese.”

1 pikë

Mbiemri: _____

23. Ndërtoni një fjali pyetëse për fjalinë e dhënë:

1 pikë

Shqipëria është një nga vendet më të njohura për prodhimin e vajit të ullirit.

24. Të shkruajmë

4 pikë

Krijoni një tekst përshkruar me temë: “Një ditë në park.”

Ideja – 1 pikë	Organizimi - 1 pikë	Stili - 1 pikë	Saktësia gjuhësore - 1 pikë	Pikët

Matematikë


25. Zbërtheni numrin:

1 pikë

375 041 = _____ QM + _____ DHM + _____ M + _____ Q + _____ DH + _____ NJ

26. Shkruani në figurën bosh gjysmën e numrit të dhënë:

1 pikë



27. Shkruani si numëror numrin e shprehur “Katër milionë e tridhjetë mijë e shtatëqind e një”.

1 pikë

28. Plotësoni barazimin e mëposhtëm.

1 pikë

5,08 km = _____ m

29. Vesa përdori makinën llogaritëse për të shkruar numrin 1 363. Ajo shtypi gabimisht numrin 1 963.

1 pikë

Me cilin veprim duhet të vijojë Vesa, që të korrigjojë gabimin.

- A) + 600
- B) - 600
- C) + 60
- D) - 60

30. Me shifrat e dhëna në diagramë, formoni numrin katërshifror, më të vogël, çift:

1 pikë




Përgjigje:

31. Dea vendosi 11 libra në një raft me gjatësi 54 cm, në pozicionin vertikal, ngjitur me njëri-tjetrin. Secili libër ishte me trashësi 2 cm. Pasi i sistemoi këta libra, nga gjatësia e raftit mbeti një hapësirë e lirë.

Sa cm është gjatësia e hapësirës së lirë në këtë raft?


Zgjidh me hapa situatën problemore.

2 pikë



32. Figura në të cilën drejtëza e simetrisë **nuk** është vizatuar saktë, është: _____

1 pikë



33. Vesa duhet të grumbullojë gjithsej 20 lloje të ndryshme gjethe bimësh, si detyrë në lëndën e diturisë së natyrës. Ajo ka në dispozicion tri ditë për t'i grumbulluar ato.

Bazuar edhe te të dhënat e tabelës, cila nga shprehjet e mëposhtme paraqet numrin e gjetheve që duhet të grumbullojë Vesa ditën e tretë?

1 pikë

- A) $2 \times 6 - 20$
 B) $20 - 2 \times 6$
 C) $20 + 12$
 D) $20 - 6$

Dita e parë	Dita e dytë	Dita e tretë
6 gjethe	6 gjethe	?

34. Vlera e shifrës së nënvizuar te numri 987,4 tregon:

1 pikë


- A) njëshet.
 B) dhjetëshet.
 C) qindëshet.
 D) të dhjetat.

35. Më poshtë paraqitet trekëndëshi kënddrejtë në kulmin $\hat{C}$.

Sa është masa e këndit $\hat{A}$, kur masa e këndit $\hat{B}$ është 55° ?

1 pikë


- A) 35°
 B) 45°
 C) 55°
 D) 90°



36. Perimetri i drejtkëndëshit në figurë është:

1 pikë

- A) 22 cm
 B) 44 cm
 C) 88 cm
 D) 120 cm



37. Renditni thyesat $\frac{3}{4}$; $\frac{1}{3}$; $\frac{4}{6}$, nga më e vogla te më e madhja.


1 pikë

Përgjigje: _____, _____, _____

38. Plotësoni barazimin: 1 orë e 30 minuta + 48 minuta = ____ orë ____ minuta **1 pikë**

39. Zbritni nga numri 3 582, numrin 1 069. **1 pikë**

40. Një grup nxënësish u pyetën se çfarë konsumojnë zakonisht gjatë orës së pushimit. Më poshtë paraqitet diagrami me shtylla për të dhënat e grumbulluara. **2 pikë**




a) Sa nxënës janë pyetur gjithsej? _____


b) Cili është ushqimi që konsumohet më tepër? _____

41. Gjeni vlerën që mungon në $\square$, në mënyrë që barazimi $(8 - 3) \times 2 = \square + 1$ të jetë i vërtetë. **1 pikë**
Përgjigje: $\square$

42. Emërtoni trupin gjeometrik të paraqitur në figurë. **1 pikë**
Përgjigje: _____




43. Shkruani koordinatat e pozicionit të yllit në rrjetë. **1 pikë**
Ylli (____; ____)



Dituri natyre

44. Cili nga materialet prodhohet nga njeriu? **1 pikë**
A) Shkëmbi.
B) Qelqi.
C) Druri.
D) Metali.


45. Në figurë tregohet një njeri që shtyn të njëjtën kuti në dy sipërfaqe të ndryshme: në sipërfaqen e lëmuar dhe në sipërfaqen e ashpër. Në cilën prej dy sipërfaqeve, ky njeri do ta shtyjë më me lehtësi kutinë? Pse? **2 pikë**



46. Shkruani një nga funksionet që kryejnë rrënjët e bimëve. **1 pikë**

47. Cilin element të qarkut elektrik përfaqëson numri 3?

- A) Llambën.
- B) Baterinë.
- C) Çelësin.
- D) Telin përcjellës.



1 pikë

48. Çfarë ndodh si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet?

- A) Formohet viti.
- B) Formohen stinët.
- C) Formohen muajt.
- D) Formohet dita dhe nata.

1 pikë

49. Skeleti i njeriut shërben:

- A) për të përmirësuar procesin e tretjes.
- B) për të rregulluar ritmin e zemrës.
- C) për të mbështetur trupin.
- D) për të marrë frymë.

1 pikë

50. Çfarë ndodh me ujën kur vlon?

- A) Ndryshon ngjyrë.
- B) Bëhet më i rëndë.
- C) Ndalohet së bëri fluska.
- D) Kthehet në avuj uji.

1 pikë

51. Në figurë tregohet luleradhiqja. Jepni një arsye pse shpërndarja e farave të luleradhiqes bëhet nëpërmjet erës.



1 pikë

52. Plotësoni fjalinë:

Kur afrohen polet e kundërta të dy magnetëve, atëherë ata _____ njëri-tjetrit.

1 pikë

53. Cili nga objektet në figurë është një burim drite?

Burim drite është _____.



1 pikë

54. Figura paraqet dy raste, ku një zile është vendosur: brenda një kambane qelqi me ajër dhe në rastin tjetër brenda një kambane qelqi pa ajër. Jepni një arsye pse djali nuk e dëgjon zilen në rastin e dytë.

1 pikë

